

INSTRUMENTI HORIZONTAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË

*PËR TË DREJTAT TUAJA:
DREJT
STANDARDEVE EVROPIANE*



Forcimi i drejtësisë

**Lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomik
dhe pastrimit të parave**

**Promovimi i antidiskriminimit dhe mbrojtjes
së të drejtave të grupeve të cënueshme**

Promovimi dhe mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe e medias

Mekanizmi i Koordinimit të Ekspertizës

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (*Instrumenti Horizontal*) është një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Programi mbështet autoritetet, për të harmonizuar agjendat e tyre të reformave në fushat e të drejtave të njeriut, shtetit ligjor dhe demokracisë me rekomandimet e organeve këshillimore dhe monitoruese të Këshillit të Evropës, që është gjithashtu një prioritet në procesin e zgjerimit të BE-së.



Instrumenti Horizontal mbështetet në rezultatet dhe progresin e arritur në këtë program, që prej vitit 2016, të cilat përfshijnë:

- ▶ Zbatimin e reformave në drejtësi, përfshirë në fushën e burgjeve dhe të policisë;
- ▶ Harmonizimin e mëtejshëm të legjisllacionit dhe të praktikave me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Për shembull, përafrimi i mëtejshëm i politikave, institucioneve dhe i praktikave me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (CPT) dhe opinionet e Komisionit të Venecias si dhe standardet e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).

- ▶ Politika më të forta kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Për shembull duke adresuar mangësitë e identifikuar në vlerësimet e Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit e Terrorizmit (MONEYVAL) dhe Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

- ▶ Legjisllacione/politika dhe kapacitete më të mira në lidhje me gjithëpërfshirjen dhe integritetin në edukim, luftën kundër diskriminimit, mbrojtjen e minoriteteve, qasjen e grave në drejtësi dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Për shembull, duke zbatuar rekomandimet e Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), Grupit të Ekspertëve kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA) dhe Komisionerit për të Drejtat e Njeriut, si dhe atyre rekomandimeve që rrjedhin nga monitorimi i Konventës Kuadër për Pakicat Kombëtare (KKPK) dhe Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave (ECRML).

- ▶ Mjedis dhe kushte të përmirësuara për ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias.

Për shembull, duke përafuar mëtej standardet në fushat e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias, në përputhje me Nenin 10 të KEDNJ-së.

- ▶ Përmes Mekanizmit të Koordinimit të Ekspertizës, Përfituesve iu dha këshillim për hartimin e legjislativioneve dhe politikave. Për shembull, u mundësua ekspertizë për Ligjin mbi përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë (Shqipëri); përmbledhje *Amicus curiae* mbi çështjen e shqyrtimit të apelimit në Gjykatën e Bosnje dhe Hercegovinës; Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës; Ligji për Bashkëjetesën ndërmjet Personave të së Njëjtës Gjini (Mali i Zi); Ligji për Gjendjen e Jashtëzakonshme (Maqedonia e Veriut); dhe Ligji për Barazinë Gjimore (Serbi).

INSTRUMENTI HORIZONTAL III – NJË VËSHTRIM I SHPEJTË

Programi mbulon projekte në Përfituesit e Ballkanit Perëndimor me një dimension rajonal komplementar.

Në temat e mbuluara nga Instrumenti Horizontal përfshihen:

- ▶ Forcimi i drejtësisë;
- ▶ Lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomik, dhe pastrimit të parave;
- ▶ Promovimi i antidiskriminimit dhe mbrojtjes së të drejtave të grupeve të cenueshme (përfshirë LGBTI, pakicat dhe Romët) dhe
- ▶ Promovimi dhe mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe e medias.

Buxheti i akorduar për këtë program llogaritet afërsisht në 41 milionë euro (85% financuar nga Bashkimi Evropian, 15% nga Këshilli i Evropës)

Struktura e Programit të Instrumentit Horizontal ndjek një qasje dy dimensionale:

- ▶ Bashkëpunim teknik në formën e ngritjes së kapaciteteve, ekspertizës dhe formave të tjera të mbështetjes teknike, përshtatur sipas nevojave të secilit Përfitues, për të arritur përmbushje më të plotë të standardeve evropiane;
- ▶ Mekanizmi për Koordinimin e Ekspertizës, një instrument fleksibël përmes të cilit Këshilli i Evropës ofron ekspertizë ligjore *ad hoc* dhe këshillim në nivel politikash në përgjigje të kërkesave të drejtuara nga Përfituesit. Këto kërkesa mund të adresojnë një prej katër fushave tematike të programit, por mund të fokusohen edhe në çështje të tjera që përfshihen nën mandatin e Komisionit të Venecias.



ÇFARË SYNON TË ARRIJË PROGRAMI?

■ Mbështetje e përshtatur dhe e drejtuar nga kërkesa mundësohet me synim përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe të politikave të ndryshme për përmirësimin e kapaciteteve institucionale, duke përforcuar funksionimin e institucioneve.

■ Për këtë qëllim, aktivitetet e programit përfshijnë zhvillimin e kapaciteteve, ofrimin e mbështetjes teknike dhe ekspertizës, si dhe ndërgjegjësimin në të katërta fushat tematike.

■ Faza e tretë e programit synon forcimin e qëndrueshmërisë së rezultateve të arritura, duke u garantuar në të njëjtën kohë autorësinë institucioneve Përfituese.

■ Arritjet e programit komunikohen me synimin për të siguruar një angazhim më të mirë me palët përkatëse të interesit dhe përfituesit përfundimtarë, duke zgjeruar përfshirjen dhe fuqizimin.


■ Nëpërmjet projekteve të tij, programi sjell përmirësime thelbësore për jetën e qytetarëve.

Një qasje unike

- ▶ **Projektet e përshtatura** janë projektuar në mënyrë të tillë që të adresojnë nevojat specifike në secilin vend Përfitues, pas konsultimeve me autoritetet përkatëse.
- ▶ **Fleksibiliteti** i Instrumentit Horizontal krijon mundësi për përshtatjen e programit sipas ndryshimeve të rrethanave dhe përparësive vendase, duke nxitur një autorësi të fortë vendore të rezultateve. Gjatë zbatimit, burimet mund të rishpërndahen në përgjigje të nevojave të reja të Përfituesve, në përputhje me qëllimet në tërësi të programit.
- ▶ **Dimensioni rajonal** krijon mundësi për shkëmbime ndërmjet kolegësh nga Ballkani Perëndimor mbi adresimin e sfidave të përbashkëta, ndarjen e eksperiencave dhe formimin e platformave dhe rrjeteve për këtë qëllim.
- ▶ **Çështjet ndërsektoriale** janë të integruara në projektet në zbatim. Të gjitha aktivitetet realizohen nga një qasje e drejtuar tek të drejtat e njeriut, duke përfshirë parimet e mosdiskriminimit, barazisë dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse, por edhe mbrojtjen e grupeve të cënueshme dhe të pakicave. Një fokus i veçantë i kushtohet barazisë gjinore, në përputhje me Strategjinë e Këshillit të Evropës për Barazinë Gjinore 2018-2023 dhe bazuar në paketën e instrumenteve të Integritimit Gjinor për Projektet e Bashkëpunimit, duke kontribuar në zbatimin e Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Veprimin e Jashtëm 2021–2025 (GAP III).

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile sigurohet në përputhje me Udhëzimet e Këshillit të Evropës për pjesëmarrjen e Organizatave të Shoqërisë Civile në aktivitetet e bashkëpunimit të Këshillit të Evropës dhe Udhëzuesin Praktik për Shoqërinë Civile, si dhe me Udhëzimet e BE-së për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Rajonin e Zgjerimit.

► **Një metodë pune unike, përmes trekëndëshit strategjik të Këshillit të Evropës**



Programet e asistencës teknike të Këshillit të Evropës përbëjnë një pjesë integrale të trekëndëshit strategjik unik të përcaktimit të standardeve, monitorimit dhe bashkëpunimit: zhvillimi i standardeve ligjërisht të detyrueshme është i lidhur me monitorimin e tyre nga mekanizma të pavarur dhe plotësohet nga bashkëpunimi teknik për të lehtësuar zbatimin e tyre. Projektet e Këshillit të Evropës zhvillohen dhe zbatohen në fusha ku Këshilli i Evropës ka ekspertizë të fortë si dhe vlerë të shtuar.

KONTRIBUTI NË OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM



— Njëpërmjet zbatimit të Instrumentit Horizontal dhe projekteve që ai përfshin, Këshilli i Evropës po kontribuon në **Axhendën e OKB-së 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm** duke mbështetur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (OZHQ), veçanërisht OZHQ3 (objektivi 8), OZHQ 4 (objektivat 1, 5, 7 dhe 10), OZHQ 5 (objektivat 1, 2 c), OZHQ 8 (objektivi 7), OZHQ 10 (objektivat 2, 3 dhe 7), OZHQ 13 (objektivi 2), OZHQ 15 (objektivi 7) dhe OZHQ 16 (objektivat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 10, a dhe b).

MË SHUMË INFORMACION

Këpi i Koordinimit të Instrumentit Horizontal
Drejtoria e Koordinimit të Programit
Këshilli i Evropës
Avenue de l'Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France
Tel. +33 (0)3 88 41 20 00
E-mail: Horizontal.Facility@coe.int



Programi i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë" (Instrumenti Horizontal III) është një iniciativë bashkëpunimi, që zgjat nga viti 2023 deri në vitin 2026.

Programi mbulon projektet në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë*, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Turqi.

Ai u mundëson përfituesve të përmbushin axhendat e tyre të reformave në fushat e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë dhe të jenë në përputhje me standardet evropiane, që është gjithashtu një prioritet për procesin e zgjerimit të BE-së.

**Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe Opininionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.*

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të bëjnë së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë stabiliteti, demokracie dhe zhvillimi të qëndrueshëm, duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i përkushtuar të ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës